

## **Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve**

Nr. 187/2026

Prishtinë, 26.05.2026

### **F T E S Ë**

## **Për pjesëmarrje në Seancën Konstituive të Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës**

I/E nderuar Anëtar/e i Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës

Në bazë të:

- Ligjit Nr. 2004/7 për Odën Ekonomike të Kosovës;
- Neneve 20, 21, 23.1.7, 23.1.8 dhe 23.1.9 të Statutit të Odës Ekonomike të Kosovës;
- Vendimit të Komisionit për Zbatimin e Zgjedhjeve Nr. 300/11, datë 15.05.2026, për verifikimin dhe certifikimin e përfaqësuesve të Kuvendit të OEK-ut;

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve ju njofton se përfaqësimi i biznesit/shoqatës që përfaqësoni në Kuvendin e Odës Ekonomike të Kosovës është verifikuar dhe certifikuar në pajtim me Statutin e OEK-ut dhe aktet përkatëse të procesit zgjedhor.

Në cilësinë e përfaqësuesit të certifikuar, ju ftojme të merrni pjesë në Seancën Konstituive të Kuvendit të Odës Ekonomike të Kosovës, e cila do të mbahet:

- **Data:** 04.06.2026 (e Enjte)
- **Ora:** 10:30
- **Vendi:** Hoteli EMRERALD, Prishtinë

## **Rend dite**

1. Hapja dhe kryesimi i Seancës Konstituive nga anëtari më i vjetër në moshë i përbërjes së re të Kuvendit, në pajtim me Statutin e OEK-ut;
2. Propozimi dhe zgjedhja e Komisionit Verifikues;
3. Raporti i Komisionit Verifikues për verifikimin e mandateve dhe konstatimin e kuorumit;
4. Prezantimi i kandidatit për Kryetar të OEK-ut;
5. Zgjedhja e Kryetarit në pajtim me aktet zgjedhore të OEK-ut;
6. Zgjedhja e organeve të parapara sipas Ligjit dhe Statutit të OEK-ut;
7. Të ndryshme.

Në seancë marrin pjesë vetëm përfaqësuesit e certifikuar nga Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve, të pajisur me dokument identifikues dhe autorizim përfaqësimi, sipas akteve të procesit zgjedhor.

Me respekt,

Oda Ekonomike e Kosovës

Komisioni për Zbatimin e Zgjedhjeve